



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**Lënda:** Dërgohet raporti i monitorimit për vitin 2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3**

**TIRANË**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- **Zbatimi i Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” i ndryshuar, në disa drejtime:**
- ✓ Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
- ✓ Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur, autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- ✓ Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji nr.45/2015, i ndryshuar, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991.
- ✓ Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale mbi bazën e objektit të kërkesave.
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Autoriteti në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për çdo kërkesë të paraqitur nga:

1. Institucionet për:

- ✓ verifikimin e zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë;
- ✓ verifikimin e kandidatëve për funksione të zgjedhshme;
- ✓ verifikimin e propozimeve për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit.

2. Individët per:

- ✓ njohje në cilësinë e; - të prekurit; - palës së tretë; - bashkëpunëtoreve; - të favorizuarëve të ish-Sigurimit të Shtetit.
- ✓ rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ dëmshtëpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ✓ qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve.

3. Studiuesit dhe Media për qëllime:

- ✓ kërkimore;
- ✓ historike;
- ✓ edukimi.

ndjek procedurat si më poshtë:

***Për çdo kërkesë të paraqitur nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Media, Autoriteti:***

- ✚ Pararakisht shqyrton dhe trajton në mbledhje të Autoritetit, legjitimitetin e kërkesës së paraqitur, duke vendosur ndjekjen e procedurave në vijim dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës.
- ✚ Dërgon shkresat sipas rastit dhe objektit të kërkesës për vazhdimin e procedurës institucioneve përkatëse, për kontrollin dhe verifikimin e figurës së personave, sipas të dhënave të identitetit të tyre dhe në rast mungesë të dhënash, bën me dije shkresërisht institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e të dhënave plotësuese sa më shpejt, me qëllim administrimin e dokumentacionit përkatës dhe vijimin e shqyrtimit të tij nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e verifikimit të figurës së shtetasit mbi bazën e objektit të kërkesës, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e deklasifikimit të dosjeve dhe bën bibliografinë e secilës (dosje formulare, dosje përpunimi, dokumente, fashikuj etj), në rastin kur dokumentacioni i administruar është i klasifikuar.
- ✚ Kryen përpunimin e dokumentacionit, para se ai t'i vihet në dispozicion kërkuarit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 45/2015.
- ✚ Kryen trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuari në mbledhje të Autoritetit, mbi bazën e rezultatit të verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.

### Treguesit për matjen e performancës janë:

- Numri në rritje të kërkesave nga Institucionet, Individët, Studuesit dhe Mediat të trajtuara nga ana e Autoritetit;
- Numrin i ankesave në raport me vendimet e marra nga ana e Autoritetit;

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2020, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave.

### Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare

Për vitin 2020, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë:

*Në mijë lekë*

| Nr | Emërtimi                        | Buxheti Fillestar Viti 2020 | Buxheti me ndryshimet Viti 2020 | Realizimi faktik 2020 |       |
|----|---------------------------------|-----------------------------|---------------------------------|-----------------------|-------|
|    |                                 |                             |                                 | Në vlerë              | Në %  |
| 1  | Planifikim-Menaxhim-Administrim | 83 000                      | 78 000                          | 63 361                | 81.2% |

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2020, jepet në tabelën e mëposhtme:


*Në mijë lekë*

| Llog | Emërtimi                     | Buxheti Fillestar Viti 2020 | Buxheti me ndryshimet Viti 2020 | Realizimi faktik Viti 2020 |              |
|------|------------------------------|-----------------------------|---------------------------------|----------------------------|--------------|
|      |                              |                             |                                 | Në vlerë                   | Në %         |
| 600  | Fondi i Pagave               | 59 500                      | 51 300                          | 44 126                     | 86.0%        |
| 601  | Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.  | 4 500                       | 9 700                           | 6 989                      | 72.0%        |
| 602  | Mallra dhe shërbime të tjera | 18 000                      | 16 000                          | 11 364                     | 71.0%        |
| 231  | Kapitale të Trupëzuara       | 1 000                       | 1 000                           | 882                        | 88.2%        |
|      | <b>T o t a l i</b>           | <b>83 000</b>               | <b>78 000</b>                   | <b>63 361</b>              | <b>81.2%</b> |

- **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore**, është realizuar respektivisht në vlerën **44 126 (në mijë) lekë** për paga si dhe **6 898 (në mijë) lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, ose 79 % të planit vjetor të këtij shpenzimi (600-601).
- Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit të rekrutimeve të personelit, situatë e krijuar nga përhapja e virusit covid-19. Ndërkohë po vijohet me plotësimin e vendeve vakante sipas planit të rekrutimeve të miratuar në mbledhjen e Autoritetit.
- Është punuar për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Autoritetit (për periudhën janar-gusht), nëpërmjet trajnimeve të ASPA
- **Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime** (zëri 602 -606) për periudhën 12 –muajore 2020,

është realizuar për:

- Shpenzime për kancelari, 672 154 lekë
- Kuti dhe dosje speciale, në vlerën 3 405 600 lekë.
- Materiale për pastrim, dezinfektim, në vlerën 295 848 lekë.
- Blerje tonerësh, në vlerën 700 800 lekë.
- Uniforma dhe veshje speciale për arkivin, në vlerën 731 880 lekë.
- Shpenzime për energji elektrike dhe ujë, respektivisht 1 610 690 lekë dhe 147 960 lekë
- Janë likuiduar faturat për shërbimin e internetit sipas kontratës në vlerën 111 600 lekë.
- Shpenzime postare sipas kontratës së lidhur me Postën Shqiptare, në vlerën 89 630 lekë.
- Shpenzime transporti për taksa, transport nga të tretët dhe siguracion të automjeteve, në vlerën 72 523 mijë lekë.
- Shpenzime në funksion të realizimit të aktiviteteve të Autoritetit për printime banera, në vlerën 58 200 lekë.
- Për udhëtime, fondi total i shpenzuar është 671 333 lekë, nga të cilat:
  1. Dieta në vlerën 367 577 lekë
  2. Bileta në vlerën 303 756 lekë.
- Mirëmbajtje programi Alpha, në vlerën 117 847 lekë.
- Mirëmbajtje pajisje kompjuterike, në vlerën 69 285 lekë.
- Shpenzime për honorare, ku përfshihen pagesat e pedagogëve që marrin pjesë në komisionet e rekrutimit të punonjësve të rinj në vlerën 164 000 lekë.
- Shpenzime përkthimi në vlerën 269 079 lekë.
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca në vlerën 698 640 lekë.



Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit tërësisht i të gjithë aktiviteteve brenda e jashtë shtetit (të planifikuara), nga situata e pazakontë e krijuar nga përhapja e covid-19, për shkak të së cilës nuk janë ndërmarrë procedura prokurimi dhe jo vetëm. Për shkak të situatës së pazakontë të krijuar nga përhapja e virusit, janë rishikuar shpenzimet e planifikuara për t'u kryer, duke i orientuar drejt prioriteteve, për sigurimin dhe garantimin e mbrojtjes së shëndetit të stafit, por edhe në të tjera shpenzime sipas situatës dhe kufizimeve të shpallura.

**Fondi për shpenzime investime (zëri 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve është 1.000 (në mijë) lekë. Realizuar në vlerën 772 080 lekë, ku fondi prej 744 480 lekë janë blerë pajisje kompjuterike dhe 27 600 lekë janë shpenzuar për kolaudimin e punimeve të godinës.

Gjithashtu, është ndjekur në vijimësi **realizimi i financimit të huaj** (Kap 2) nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së )dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne”, treguesit e së cilës janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Llogaria      | Në Lek               |
|---------------|----------------------|
| 600           | 865,971.00           |
| 601           | 396,351.00           |
| 602           | 4,400.00             |
| 231           | 14,883,544.00        |
| <b>TOTALI</b> | <b>16,150,266.00</b> |

Autoriteti ka nënshkruar një marrëveshje me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin: "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë kalimtare dhe pajtuese: zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” i cili ka financuar në vlerën **4 919 (në mijë) lekë** (Kap 6) nga të cilat është realizuar në vlerën **362 (në mijë) lekë** për paga dhe kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore. Ky projekt sipas marrëveshjes do zgjasi për një periudhë 2 vjeçare.

### Të ardhurat nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave tw tretw

Për periudhën e raportuar, Autoriteti arkëtoi të ardhura nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave target grup iligjit 45/2015, I ndryshuar, për riprodhimin e informacionit dhe dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në vlerën 264 140 lekë. Të ardhurat derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

### Krahasimi i të dhënave faktike ndërmjet Autoritetit dhe Thesarit


Në mijë lekë

| Nr | Emertimi i programit                | Shpenzimet korente |         | Shpenzimet kapitale |         | Totali     |         | Diferenca |
|----|-------------------------------------|--------------------|---------|---------------------|---------|------------|---------|-----------|
|    |                                     | Autoriteti         | Thesari | Autoriteti          | Thesari | Autoriteti | Thesari |           |
| 1  | Planifikim - menaxhim - administrim | 78 000             | 78 000  | 1 000               | 1 000   | 63 361     | 63 361  | 0         |


Në **Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) nga kryerja e aktiviteteve, në zbatim të objektivave për vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, në gjuhën e shifrave rezulton se:


- Janë paraqitur për legjitimim **282 kërkesa individuale**,
- Janë mbyllur në total **509 kërkesa individuale**, nga të cilat:
  - **27 kërkesa të 2018,**
  - **292 kërkesa të 2019,**
  - **190 kërkesa të 2020.**



- Janë paraqitur 106 kërkesa institucionale, për verifikimin e 217 kandidatëve,
  - janë mbyllur procedurat e verifikimit për 214 kandidatë,
  - 11 kandidatë (individë) kanë rezultuar me probleme.





- Është paraqitur 1 kërkesë individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi;
- Janë paraqitur 117 kërkesa individuale dhe institucionale ISSH-së për efekt pensionesh, për 122 shtetas;
- Janë përgatitur 633 vendime (485 individuale + 148 institucionale).
- 




Në total, në përmbledhje të shifrave për periudhën 12 mujore, 1 janar – 31 Dhjetor 2020 janë paraqitur për:

- legjitimim, 280 kërkesa të reja;
- mbyllje procedure, 509 kërkesa, për të cilat:
  - janë përgatitur 485 vendime.
  - me dokumentacion arkivor janë 327 kërkesa (ku 15 janë zbardhje b.p),
  - pa dokumentacion arkivor janë 170 kërkesa.





- Janë përpunuar më shumë se 130.000 faqe dokumentacion arkivor.
- Janë anonimizuar mbi 43.000 faqe dokumentacion arkivor i digjitalizuar.



Për vitin 2020 ka rënie të lehtë, por të justifikuar në numrin e kërkesave të paraqitura nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, në numrin e kandidatëve të verifikuar dhe në numrin e vendimeve të dala drejtuar institucioneve kushtetuese, kjo për arsye të ndërprerjes së procedurave të verifikimit për kandidatët që emërohen e ngrihen në detyrë për një periudhë disamujore, deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore në ligjin 45/2015, i ndryshuar.


### **Trajtimi i kërkesave individuale për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi**

Gjatë 2020 janë marrë në shqyrtim dhe trajtuar 117 kërkesa për 122 shtetas, kërkesa për efekt pensioni, duke bërë verifikimin e faktit të qenies në kampet e vuajtjes së dënimit (minierë) si dhe verifikimi i faktit të qenies në internim të personave.

Nga kërkesat e paraqitura janë përmbyllur dhe kthyer përgjigje për 99 praktika, ndërsa 23 të tjera janë në proces verifikimi.




## Vërtetime për efekte pensioni, për ish të përndjekurit politikë



Në lidhje me këto kërkesa, për 65 prej tyre është kthyer përgjigje se ka pasur dokumentacion dhe për 34 ka rezultuar se nuk është gjetur dokumentacion.


### Kërkesa të Mbyllura



Krahasuar me vitin 2019, ku rezultonte se:

- Janë paraqitur për legjitimim 135 kërkesa të reja, për verifikimin e 286 kandidatëve, përpara emërimit, ngritjes në detyrë apo dekorim;
- Janë mbyllur procedurat e verifikimit për 342 kandidatë, nga të cilët 16 kandidatë figuruan me dokumente;
- Janë marrë 190 vendime nga Autoriteti.

### Krahasimi 2019/2020



Gjatë vitit 2020, është paraqitur vetëm 1 kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, e cila është trajtuar dhe kthyer përgjigje.

Në kuadër të së Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në zbatim të parashikimeve të ligjit 119/2014, pranë AIDSSH-së janë paraqitur gjithsej 6 kërkesa për periudhën janar-dhjetor 2020, përgjigjet e të cilave janë dhënë brenda afateve ligjore.



## **Trajtimi i kërkesave për qëllime studimore**

### **1.1. Praktika të paraqitura gjatë vitit 2020**

Gjatë vitit 2020, pranë Autoritetit janë paraqitur **114 kërkesa** studimore/mediatike, të cilat janë në faza të ndryshme të trajtimit të tyre. Nga këto kërkesa, të cilat e kanë kaluar procesin e legjitimit, **48 praktika janë të mbyllura**. Materialet janë trajtuar dhe dokumentacioni i gjetur nga Drejtoria e Arkivit është përpunuar dhe është vënë në dispozicion të studiuesve/medias kërkuese të informacionit. Për dosjet e trajtuara në 2020 është mbajtur përmbledhje, duke bërë evidentim të të dhënave përkatëse. Të gjitha kërkesat e tjera, **66**, janë trajtim e sipër.


Ndër praktikat e trajtuara, në total 114:

- 89 janë paraqitur nga studiues dhe institucione kërkimore;
- 25 nga media dhe institucione mediatike;
- 98 kërkesa për informim janë bërë nga studiues vendas;
- 16 nga studiues dhe institucione të huaja;




Po ashtu, janë trajtuar dhe mbyllur rreth **37** kërkesa të mbartura nga viti 2019 dhe **35** kërkesa të vitit 2018, ndërsa janë në proces dhe janë trajtuar pjesërisht rreth 19 kërkesa shumëfishe, që duan kohë më të gjatë kërkimi në arkiv.

### 40 kërkesa të mbartura nga viti 2018




■ Kërkesa në proces ■ Kërkesa të mbyllura

### 51 kërkesa të mbartura nga viti 2019



■ Kërkesa në proces ■ Kërkesa të mbyllura

### 120 kërkesa të mbyllura gjatë vitit 2020 nga DMSHEQ




Gjatë trajtimit të secilës kërkesë, sektori ka mbajtur komunikim me kërkuarësit e dokumentacionit, duke u shpjeguar fazat nëpër të cilat kalon praktika, mbajtur të informuar dhe kërkuar informacione shtesë për verifikimin e të saktë të dokumentacionit për të cilin është aplikuar. Studiuesit janë konsultuar me dokumentacionin e gjetur nga Drejtoria e Arkivit, pas vendimeve të Autoritetit, dhe kanë firmosur deklarata të konfidencialitetit, të bashkë-nëshkruara nga DMSHEQ dhe një anëtar i Autoritetit.

## 1.2. Trajtimi i dokumenteve arkivore, anonimizimi, vënia në dispozicion

Qëllimi i Autoritetit për t'i siguruar të drejtën çdo qytetari, studiuesi, medie për të shqyrtuar informacionin e ish-Sigurimit të Shtetit, duke mbrojtur privatësinë dhe identitetin e palëve të treta, po ashtu duke qenë transparentë, realizohet në zbatim të ligjit 45/2015, i ndryshuar.

Dokumentet arkivore, para se të vihen në dispozicion të kërkuarëve shkencorë apo medias, kalojnë në procesin e anonimizimit, që bën të palexueshme të dhënat personale dhe sensitive. Gjatë vitit 2020 janë vënë në dispozicion 451 dosje, me rreth 68.396 faqe, ndër të cilat rreth 17.557 kanë kaluar në proces anonimizimi.



### Aktivite të kryera

Për qëllim të edukimit qytetar, sipas kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit e ndërgjegjësimit të shoqërisë, janë organizuar dhe mbështetur një sërë veprimtarish. Duke iu përshtatur kushteve të krijuara nga pandemia Covid 2019, nga marsi në dhjetor 2020, për veprimtaritë është koordinuar infrastruktura përkatëse, janë përgatitur ftesa, programe, shpërndarje dhe informacione e njoftime për shtyp, për komunikim të zgjeruar me partnerët dhe publikun e interesuar.

### Sfida për të ardhmen:

- Standard sa më të lartë informacioni, që do të thotë, së pari gjithshka që kërkohet sipas objektit të kërkesës dhe së dyti dhënia e informacionit për gjithshka të lidhur me objektin e ligjit 45/2015, i ndryshuar,
- Përgatitjen cilësore të materialeve informuese mbi dokumente të ish-sigurimit të Shtetit dhe vënien e tyre në dispozicion organizatorëve, në funksion të konferencave, takimeve, workshopeve, programeve trajnuese, me qëllim krijimin e një kulture gjithpërfshirëse,

- për njohje me dokumentacionin arkivor, të krijuar nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit,
- c. Gjetjen e mënyrave dhe mjeteve më efikase për të shpërndarë informacion, si në drejtim të edukimit, sensibilizimit apo informimit të qytetarëve dhe rinisë në veçanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që ju përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshëm të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të mara autentikisht nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit,
  - d. Bashkëpunimin me median, të cilën e shikojmë si promotor për të gjitha grupet e interesit, vecanërisht për studiuesit, duke e kthyer këtë institucion në një bibliotekë të hapur lehtësisht të aksesueshme, për të gjithë ata që u takon me ligj, ashtu siç është emërtuar edhe vetë ky institucion.

Realizimi i buxhetit për vitin 2020 u monitorua me përgjegjesi dhe u kërkua angazhimi i të gjitha strukturave të Autoritetit me qëllim realizimin me efektivitet të fondeve të planifikuara për vitin 2020.

Materiali është i publikuar në faqjen zyrtare të Autoritetit : [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Skënder Vrioni**